



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

Nr. 6288/ Prot.

Lezhë, më 26 .05 . 2020

LËNDA : **Pergjigje kerkeses tuaj me Nr.164.Prot date 19.05.2020**

DREJTUAR : KOMITETIT SHQIPTAR TE HELSINKIT

Znj . ERIDA SKËNDAJ

(Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar te Helsinkit)

Ruga Birgada e VIII Pallati Tekno Projekt,Shkalla 2 Ap.10 Kati 6

TIRANË

Bashkelidhur ju dergojme : Pergjigje kerkese nr.164.prot. date 19.05.2020 e ardhur ne forme elektronike .

Vendimin per Caktimin e njesise Pergjegjese Per Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nr 87 date 22.01.2020 per vitin 2020

Rraportin e veprimtarise te dorzuar prane ILDKPKI .

**KRYETARI
PJERIN NDREU**

Ne munges e porosi
SEKRETARI I PERGJITHSHEM
Reinis ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Prot 822

URDHER

Nr 87 Date 22.01.2020

NGRITJEN E NJESISE PERGJEGJESE PER SINJALIZIMIN DHE
MBROJTJEN E SINJALIZUESVE

Ne mbeshtetje te ligjit nr .139/2015 `` Per Vetqeverisjen Vendore `` neni 8 pika 2 ,neni 9 pika 1.1 germa ``b`` neni 64 ,germa `` g `` dhe ``gj`` dhe ne zbatim te ligjit nr.60/2016 ``Per Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve `` , VKM .nr.816 date 16.11.2016 `` Per strukturen , Kriteret e perzgjedhjes dhe te mardhenjeve te punes te punonjesve te Njesise pergjegjese ne autoritetin publik `` ,ne zbatim te ligjit nr.60/2016 `` Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve

URDHEROJ:

1. Ngritjen e Njesise Pergjegjese Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Bashkise Lezhe e përbërë :
 1. Bib Gjoni Përgjegjes i Njesisë
 2. Pranvera Filipaj Antare e njësisë.
2. Njesia Pergjegjese te hartoje Planin e veprimit Vjetor dhe te zhvilloje veprimtarine e tij ne baze te ligjit nr . 60/2016 `` Per sinjalizimin de mbrojtjen e sinjalizuesve``, VKM. nr.816 date 16.11.2016 `` Per strukturen , Kriteret e perzgjedhjes dhe te mardhenjeve te punes te punonjesve te Njesise pergjegjese ne autoritetin publik.
3. Per zbatimin e ketij urdheri ngarkohet Sektori Auditit prane Bashkise Lezhe
4. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere .

KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE

SEKTORI I AUDITIMIT TE BRENDSHEM

Njesia Pergjegjese Per Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit

Nr. 1085 Prot.

Date 27 / 01 / 2020

Lënda :Raport mbi `` Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve ``

Drejtuar : ILDKPKI (Inspektorati i Larte i Deklarimit Kontrollit Pasurise dhe Konfliktit
Interesave)

TIRANE

I Njesise Pergjegjese per zbatimin e Ligjit Nr. 60/2016 " Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e
Sinjalizuesve " ne Bashkine Lezhe

Ne zbatim te ligjit nr.60/2016 "Per Sinjalizimin dhe mrojtjen e sinjalizuesve " dhe te VKM nr.816 date 16.11.2016 " Per strukturen , Kriteret e perzgjedhjes dhe te mardhenjeve te punes te punonjesve te Njesise pergjegjese ne autoritetin publik ". Ne zbatim te ligjit 60/2016 " Per sinjalizuesit dhe mrojtjen e sinjalizuesve " ne Bashkine Lezhe me urdher te Kryetarit te Bashkise nr .14 date 27/01/2017 dhe urdher nr. 133 date 13.08.2018" Per ngritjen e njesise pergjegjese ne zbatim te ligjit nr. 60/2016 si dhe te VKM nr. 816 date 16.11.2016 ,ku ne zbatim te ligjit dhe VKM se sipershenuar, kjo strukture perbehet nga P/sectorit te Auditimit znj,Jasemina Voci deri me daten 13 gusht 2019 dhe specialistin e auditit z. Bib Gjoni .


Nga Njesia pergjegjese e ngarkuar ne zbatim te urdherit nr. 133 date 13.08.2018 u percaktua Njesia e Sinjalizimit me sinjalizues znj,Jasemina Voci Pergj/sectoritAuditit ,njekohesisht edhe Pergj/Njisise se Sinjalizimit dhe z,Bib Gjoni sinjalizues . Aktualisht per periudhen qe sot po hartojme këtë raporte ju bëjmë me dije se prane njesise pergjegjese nuk eshte dhene ndonje informacion konkret me ndonje pretendim per veprime abusive apo korruptive. Prandaj njesia

deklarimet e pasurise per ato punonjes qe mbartin detyrimin e plotesimit te deklarates se pasurise , gjatë vitit raportues,jemi perpjekur te forcojme më tej rolin e kesaj strukture e ne pergjithsi edhe te sektorit te auditimit brenda se ciles ushtrojme pergjegjesite tona ligjore dhe funksionale për kontrollin e deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit, si dhe marrim përgjegjësi të reja, të cilat zgjerohen me fushën e veprimit dhe te monitorimit ne zbatim te ligjit nr. 60/2016 "Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve", si dhe në procesin e vlerësimit të vazhdueshem te ndryshimit te kuadrit ligjor .

Pergjegjesi I Sektorit Auditimit


& specialist I Njesise Pergjegjese

Bib GJONI



KRYETARI

Pjerin NDREU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Njesia Pergjegjese per Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit

Nr. 6288 prot.

Lezhe me 26 /05/2020

Lënda: Pergjigje e kerkeses per Informacion lidhur me zbatimin e ligjit nr. 60/2016” Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve ” dhe te akteve ligjore ne zbatim te tij.

Drejtuar : Komitetit Shqiptar te Helsinkit Znj. Enkelejda Skendaj Drejtore Ekzekutive e Komitetit Shqiptar te Helsinkit.

Rruga ” Brigada e VIII” Pallati tekno Projekt Ap.10 kati 5 Tirane.

Në përgjigje te kerkese tuaj per informacion lidhur me zbatimin e ligjit 60/2016 ”Per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve ” dhe te VKM nr.816 date 16.11.2016

Ne Bashkine Lezhe eshte ngritur njesia Pergjegjese per Sinjalizimin dhe mbrojtjen e e sinjalizuesve me urdheri te Kryetarit te bashkise nr. 14 date 27.01.2017 me Pergjegjes te Njesise Sinjalizimit z. Petrit Marku njekohesisht P/Sektorit te Auditimit dhe zj. Pranvera Filipaj specialiste njekohesishte edhe Audituese e Sektorit te Auditimit.

Kjo Njese ne vit 2018 eshte ndryshuar me urdherin e K/Bashkise nr. 17 date 25.01.2018 ku jane caktuar z. Gjon Marku Pergjegjers i njesise Sinjalizimit njekohesishte P/Sektorit te auditimit dhe Bib Gjoni Audirtues.

Me urdherin nr.133 date 13.08.2018 drejtuesi i njesise se Sinjalizimit eshte emruar

znj. Jasemina Voci deri me 13.08.2019 dhe per vitin 2020 me urdher te kryetarit te Bashkise Lezhe nr.87. date 25.01.2020 eshte caktuar njesia Pergjegjese per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve e perbere nga z. Bib Gjoni me Funkcion Pergjegjes i Sektorit te Auditimit dhe znj. Pranvera Filipaj me funksion Specialiste e Auditimit.

Siç e shpjeguar me larte Njesia pergjegjese eshte ndryshuar disa here .

Per njesine pergjegjese per Sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nuk eshte bere ndonje trajnim.

Nga kjo njesi nuk eshte regjistruar asnje rast ku te jene sinjalizuar veprime korruptive apo te demtimit te prones.

Njesia pergjegjese per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nuk ka regjistruar sinjalizime ,se pari se kjo njesi eshte me perberje nga Auditimi i Brendshem i Bashkise , qe ka akses mbi verimtarin e bashkise si rezultat i kryerjes se misioneve te auditimit . Se dyti mund te themi se nuk eshte bere sensibilizimi ne nivelin e duhur, mund te duan me denancu te keqen por hezitojne.

Vazhdimisht Njesia Pergjegjese eshte Caktuar me 2(dy) puononjes. Dhe nga Sektori i Auditimit.. Specialistet e caktuar ne njesin e Snjalizimit sot jane te çertefikuar Audit te Brendshem ne Sektorin publike dhe per kete fushe ndjekin trajnimet e vijueshme çdo vit nga 40 orë, ndersa per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nuk jane trajnuar sepse nuk u eshte ofruar njdonje trajnim specifik nga ILDKPKI.

Veprimtarin e kesaj Njesie ILDKPKI e ka monitoruar nepermjet raporteve periodike vjetore . Nuk ka pasur raste te sinjalizimit pasi nuk jane ofruar sinjalizues ,kjo eshte e lidhur edhe me mentalitetin. Per rrjedhoje nuk ka pasur edhe raste te hakmarrjes..

Kerkesa u muar nga njesia pergjegjese per sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve me date 20/05/2020 ora 14.00 dhe po mi japim pergjigje sot data 21.05.2020 ora 10.00.

Per njesine e sinjalizimit

P/Sektorit Te Auditimit

Bib Gjoni

Bashkia Lezhë,Kodi postar 4501,kryetari@lezha.gov.al,web:www.lezha.gov.al